

• Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës • Mreža Žena Kos
• Kosova Women's Network • Kosova Women's Network
• Mreža Žena Kosova • Rrjeti i Grupeve të Grave të Kos
es • Mreža Žena Kosova • Rrjeti i Grupeve të Grave të Kos

**RRJETI I GRUPEVE TË
GRAVE TË KOSOVËS**

RAPORTI VJETOR 2010



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës Raporti i Programit dhe Aktiviteteve 2010

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

+381 (0) 38 245 850

Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8

10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

info@womensnetwork.org

www.womensnetwork.org



MISIONI I RRJETIT TË GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS (RRGGK)

RrGGK përkrah, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga qëndrimi politik, religjioni, moshë, niveli i arsimimit, orientimi seksual apo aftësitë tjera.

RrGGK përmbush misionin e saj përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, avokimeve dhe hulumtimeve.

PËRMBAJTJA

Objektivat e RrGGK	2
Programet e RrGGK	3
PLANI STRATEGJIK Hyrje	9
Zhvillimi i Kapaciteteve të RrGGK	10
Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje	14
E Drejta e Grave në Programin e Kujdesit Shëndetësor	24
Programi Kundër Dhunës në Familje dhe Trafikimit	28
Bordi i RrGGK 2010	32
Stafi i RrGGK 2010	33
Raporti i Auditorit	34
Raporti Financiar	35
Anëtarët e RrGGK 2010	37

OBJEKTIVAT E RRGK

- I.** Të sigurojë pjesëmarrje të barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimin politik, ekonomik dhe social të Kosovës;
- II.** Të përmirësojë të drejtat njerëzore të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë; dhe
- III.** Të përmirësojë dhe ngrisë nivelin e bashkëpunimit mes grupeve dhe organizatave të grave në Kosovë, rajon dhe kontekst ndërkombëtar.

PROGRAMET E RRGGK-së

1. Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Politikë dhe Vendim-Marrje

Njohuria për mekanizmat ligjor ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të grave është e rëndësishme për fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendim-marrje. Prandaj, RrGGK ka përfunduar fushatën vetëdijësuese për mekanizmat e barazisë gjinore në Kosovë, mbështetur nga UNIFEM (aktivitet i planifikuar i RrGGK-së). Në këtë fushatë u mbajtën takime në 12 komuna ku morën pjesë përafërsisht 350 gra dhe u shpërndanë fletëpalosje me informata për Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1325 (RKS KB 1325) për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Në dhjetëvjetorin e Rezolutës 1325, RrGGK bashkëpunoi me Ministrinë e Administratës Publike për të bashkë-organizuar konferencën mbi gratë dhe sigurinë më 15 nëntor. Edhe pse ka pasur progres, gratë mbeten akoma të margjinalizuara në marrjen e vendimeve që lidhen me paqen dhe sigurinë në Kosovë, thanë pjesëmarrësit.

Edhe gjatë vitit 2010, RrGGK ka vazhduar avokimin për ngritjen e pjesëmarrjes së grave në Sektorin e Sigurisë. RrGGK u përqëndrua veçanërisht në përfshirjen e grave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, edhe pse ministri i Punëve të Brendshme ka dhënë vetëm premtime për të përfshirë më shumë gra. Pas zgjedhjeve qendrore në dhjetor, RrGGK do të vazhdojë të avokojë për përfshirjen e grave. Një sukses në vitin 2010 ishte reagimi me shkrim që RrGGK ka i dërguar KFORit lidhur me portretizimin e kosovarëve në reklamat e KFOR-it, dhe si rezultat i kësaj KFOR-i ka filluar konsultimet e rregullta me RrGGK në hartimin e të gjitha materialeve promovuese të KFOR-it.

RrGGK, gjithashtu ka marrë pjesë rregullisht në Grupin Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore (SGCG), i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shtetërore (Policia e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Kryeministrit), organizatat e grave, EUSR, EULEX-i, OSBE-ja, NATO-s dhe të agjencive të OKB-së. Qëllimi i këtij grupi është që të rrisë koordinimin dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet organizatave vendore dhe ndërkom-bëtare të përfshirë në çështjet gjinore dhe për të nxitur veprimet strategjike të përbashkëta që kanë për qëllim rritjen e sigurisë për gratë.

Në maj, autori i raportit të monitorimit të parë në punën e EULEX-it, profesor Helmut Krammer nga Universiteti i Vjenës, ka ftuar në Vjenë ekspertë të shoqërisë civile duke përfshirë edhe RrGGK-në, për të shkruar një dokument politik për BE-në lidhur me të ardhmen evropiane të Kosovës. Përvoja dhe puna e RrGGK-së, i mundësoi RrGGK-së për të

komunikuar me palët e interesuara në Komisionin Evropian, Bashkimin Evropian dhe Parlamentin Evropian.

Drejt rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë, RrGGK gjithashtu ka organizuar edhe një takim me gratë kosovare dhe anëtarin e Parlamentit Evropian/raportuesen për Kosovën Ulrike Lunacek, më 28 nëntor 2010. Gratë aktiviste ngritën disa çështje, duke përfshirë rëndësinë e lirisë së lëvizjes dhe liberalizimin e vizave, pjesëmarrjen dhe fuqizimin e grave në politikë dhe në vendim-marrje, për nevojën për të mbështetur financiarisht organizatat e grave, dhe përfshirjen e grave të shoqërisë civile në bisedimet e ardhshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë .

Së fundi, plani i punës për vitin 2010 parashikoi se RrGGK do të bënte një hulumtim dhe do të shkruante një raport progresi mbi zbatimin e Rezolutës 1325, në përvjetorin e 10-të të kësaj Rezolute. Megjithatë, për shkak të fondeve dhe kufizimeve në burimet njerëzore, ky aktivitet është shtyer.

2. Fuqizimi i Votuesve

Edhe pse RrGGK ka planifikuar për të ndihmuar votuesit me fushata avokuese në 10 komuna, në fund të 2009, RrGGK vërejtí se organizatat tjera përfshiheshin gjithnjë e më të shumë në nisma të ngjashme, si p.sh. Lëvizja FOL!. Prandaj, RrGGK u tërhoq nga kjo iniciativë dhe u përqëndrua në punën vetëm me gratë. RrGGK do të vazhdojnë të punojnë me gratë votuese, bazuar në strategjinë e saj të ardhshme. Edhe kështu, RrGGK ka ndërmarrë dy fushata avokimi vitit 2010.

Së pari, RrGGK ka bashkë-themeluar Këshillin e OJQ-ve, të përbërë nga 40 OJQ, kundër gjykimit të Albin Kurtit dhe për hetimin e vrasjes së dy demonstruesve më 10 shkurt 2007. Peticioni, i cili ka deklaruar këto dy kërkesa, u nënshkrua nga më shumë se 75.000 qytetarë në Kosovë dhe iu dorëzua kryetarit të Parlamentit, Dr. Krasniqit më 11 shkurt 2010.

Në një nismë tjetër avokuese, RrGGK bashkëpunoi me anëtarët e saj dhe gratë në parlament për të diskutuar mbi pushimin e lehonisë në kuadër të Ligjit të ri të Punës. Më vonë, RrGGK iu bashkangjiti një koalicioni më të gjerë të OJQ-ve të organizuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, i cili hartoi rekomandime për ligjin, të pranuar nga Parlamenti. Si rezultat, Ligji i ri i Punës ka një vit (në vend se të tre muaj të propozuar) pushim të lehonisë.

3. Përmirësimi i Shëndetit të Grave

Siç ishte planifikuar, RrGGK ka mbështetur fushatën vjetore kundër kancerit të gjirit dhe kancerit në mitër. Gjatë tetorit, Muaji Ndërkombëtar i Vetëdijësimit për Kancerin e Gjirit, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit JETA/VITA bashkëpunoi me OJQ-të tjera për të organizuar një fushatë vetëdijësimi. RrGGK përkrahu këto përpjekje duke shpërndarë informatat në lidhje me organizimin e aktivitetit të tyre.

Për të kontribuar në përgatitjen e Strategjisë së Kosovës kundër kancerit të gjirit edhe pse RrGGK ka avokuar në vazhdimësi për këtë, Ministria e Shëndetësisë vazhdimisht ka shtyrë hartimin e Strategjisë. Kufizimet buxhetore dhe ndryshimi i Ministrave mund të ketë qenë faktorë që kanë kontribuar në këto vonesa.

Së fundi, raporti i vlerësimit mbi kapacitetet e sistemit të shëndetësisë publike që kanë të bëjnë me shëndetin e grave është shtyrë për vitin 2011, sepse RrGGK ka mësuar se tashmë ekziston një hulumtim dhe është e nevojshme të shqyrtohet para se të bëhet një hulumtim i ri. Gjithashtu janë të nevojshme edhe burimet financiare.

4. Ulja e Trafikimit dhe Dhunës në Familje

Siç ishte planifikuar, përfaqësues të RrGGK kanë kontribuar në Ligjin, Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit kundër Dhunës në Familje, të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shtator. RrGGK gjithashtu ka mbështetur në ngritje fondesh për Koalicionin kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës Seksuale familjare, i përbërë nga strehimoret dhe Medica Kosova.

RrGGK gjithashtu punoi për të rritur vetëdijen në lidhje me Ligjin dhe Strategjinë kundër Dhunës në Familje. Si anëtare e Grupit Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore (SGCG), më 25 nëntor, RrGGK ka marrë pjesë në lansimin e fushatës për të shënuar "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës ndaj grave: Thuaji JO dhunës ndaj grave". RrGGK organizoi hapjen e kësaj fushate me këngë të punuara kundër dhunës ndaj grave, performuar para Teatrit Kombëtar në Prishtinë. Më tej, nga Grupit Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore, nëpër Kosovë u organizuan debate, diskutime dhe lansimi i një dokumentari mbi Ligjin e ri për dhunën në familje.

Në reagim ndaj vrasjes së një gruaje shtatzënë, gjatë 16 ditëve kundër dhunës ndaj grave, RrGGK ka organizuar ndezjen e qirinjve me 3 dhjetor, në platonë e Hotel Gradit në Prishtinë. RrGGK dënoi dhunën përmes një deklarate për shtyp.

5. Rritja e Përfshirjes së Grave në Ndërtimin e Paqes në Rajon

Gjatë vitit 2010, RrGGK ka vazhduar rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me organizatat e grave në rajon. Disa nga aktivitetet janë:

- Më 23 prill, RrGGK mori pjesë në përvjetorin e dhjetë të Qendrës për Studime Gjinore në Kroaci.
- Më 6-8 maj, RrGGK mori pjesë në konferencën rajonale "Si të depërtojmë për të ndryshuar – vend për shkëmbim, rrjetëzim dhe inspirim", të organizuar nga Kvinna till Kvinna (KTK) në Beçiq, Mali i Zi.
- Në qershor të vitit 2010, RrGGK ka qenë e përfshirë në konferencën e mbajtur në Maqedoni, mbi gratë dhe ndërtimin e paqes në Ballkanin Perëndimor, organizuar nga Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore.
- Më 25-26 shtator, RrGGK ka marrë pjesë në Konferencën e dytë Rajonale të Grave, e cila u përqëndrua në "Fuqizimin e grave në vendim-marrjen lokale," organizuar nga shoqata "Unë Gruaja" në Pogradec, Shqipëri. Temat që u diskutuan ishin: roli i grave në shoqëri, barazia gjinore, kuota për pjesëmarrje në politikë, fuqizimi i grave dhe imazhi i grave në politikë dhe në jetën sociale. Konferenca kishte për qëllim të kontribuojë në fuqizimin e grave në vendim-marrjen lokale për fushatën për zgjedhjet lokale në Shqipëri që është planifikuar të fillojë më 8 maj 2011.
- RrGGK ishte e përfshirë në një përpjekje rajonale për krijimin e Gjykatës së Grave të Ballkanit. Takimi i parë u mbajt në Sarajevë në tetor (pasi që Drejtoreshës Ekzekutive të RrGGK-së iu mohua viza, ajo mori pjesë me anë të Skype), ndërsa takimi i ardhshëm do të mbahet në dhjetor. Përpjekjet drejt krijimit të Gjykatës janë pjesë e strategjisë së ardhshme tre-vjeçare të RrGGK-së.
- Me 22-23 nëntor, RrGGK ka marrë pjesë në takimin rajonal "Të gjithë së bashku për dinjitetin e gruas", të organizuar nga shoqata Gruaja tek Gruaja në Shkodër, Shqipëri. Takimi u përqëndrua në dhunën në familje dhe se si është e mbuluar në media si çështje.
- RrGGK u takua individualisht me organizata të grave në Maqedoni për të mbështetur përfshirjen e tyre në krijimin e rrjeteve të grave në rajon.

Bazuar në planin e punës të vitit 2010, RrGGK gjithashtu vazhdoi të mbështesë dhe fuqizojë organizatat e grave serbe në Kosovë, përmes vizitave të rregullta, konsultimeve si dhe dhurimin e disa pajisjeve për zyrë.

6. Fuqizimi i Kapaciteteve të Rrjetit

Përmes këtij programi, RrGGK:

- Ka publikuar dy buletinë tremujore "Zëri i Gruas Kosovare". Në vitin 2011, RrGGK do të zëvendësojë buletin informativ tremujor të shtypur, me buletin elektronik mujor. Njëkohësisht do të kontribuojë në ekologjinë e Kosovës, meqë do të përdoret shumë më rrallë letër për printim.
- Ka publikuar dhe shpërndarë Raportin Vjetor 2009 në tri gjuhët.
- Ka mirëmbajtur ueb-faqen në tri gjuhët. RrGGK është duke pritur akoma për disa informata nga anëtarët, në mënyrë që të postojë profilet e plota të anëtareve të saj në ueb-faqe.
- Ka ofruar shërbime për anëtarët e RrGGK-së përfshirë këtu informata të ndryshme, mbështetje teknike, asistencë në shkrimin e projekt propozimeve, kontaktet me donatorët, negociata me donatorë, dhe ndihmë në përkthim. Gjithashtu ka shpërndarë informata mbi ngjarjet e ndryshme në Kosovë dhe rajon. Gjatë nëntorit dhe dhjetorit, RrGGK filloi vizitat tek donatorët e huaj për të diskutuar mbi mungesën e fondeve nëpër organizatat e grave dhe se si ata duhet të kontaktojnë drejtpërdrejtë organizatat e grave.
- Ka mbajtur mbledhjet dymujore të rregullta me anëtarët, ku anëtarët kanë marr informatat mbi aktivitetet e RrGGK-së dhe informata tjera. Me 12 dhjetor 2009, RrGGK mbajti Kuvendin e saj Vjetor të anëtarësisë, gjatë të cilit u vlerësua puna e RrGGK-së për vitin 2009 dhe u miratua strategjia për vitin 2010.
- Monitorimi i zbatimit të Kodit të Mirësjelljes dhe Përgjegjësisë të RrGGK-së, është dashur të shtyhet për vitin 2011 për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore në RrGGK.
- Meqë RrGGK nuk mundi të sigurojë të gjitha informatat për përgatitjen e një broshure me profilet e anëtareve dhe të ofrojë më shumë shërbime për anëtarët, këto aktivitete do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2011.

Aktivite tjera rrjetëzuese që RrGGK ka kryer gjatë vitit 2010 përfshijnë:

- Takime informuese për studentët dhe gazetarët për historinë e lëvizjes së grave në Kosovë dhe situatën e grave në Kosovë (p.sh., Universiteti John Hopkins, Universiteti i Lublanës, Shkolla e Re, Universiteti i Prishtinës).
- Pjesëmarrja në konferencën "Shoqëria civile përtej dialogut formal" më 11 shkurt në Prishtinë, organizuar nga projekti për asistencë teknike për shoqërinë civile (TACSO).
- Shkëmbim përvojash me një grup të organizatave nga Japonia, mbajtur në shkurt, mbështetur nga Zyra Japoneze në Prishtinë.
- Pjesëmarrja në seminarin "Tregimi i rrëfimit - mjet i mirë për terren", organizuar nga Kvinna till Kvinna në Stokholm, më 11-13 tetor.

Aktivitetet tjera

- Me 23 dhjetor 2009, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së, Igballe Rogova, ishte në mesin e 16 grave dhe institucioneve që u shpërblyen me mirënjohje nga Grupi jo Formal i Grave Deputete. Mirënjohja ishte për kontributin e tyre të veçantë për avancimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare.
- Me 8 mars, premiera e shfaqjes "Kurrë më" u dha në amfiteatrin e Shkollës Amerikane në Kosovë. Shfaqja është e bazuar në rrëfimet e vërteta që gratë kanë përjetuar gjatë luftës në Kosovës. Këto rrëfime u përshtatën sipas librit të Sanije Gashit.

PLANI STRATEGJIK I RRGK-së 2011 – 2013

Hyrje

Misioni i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) është të përkrahë, mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anembanë Kosovës, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, religjionin, moshën, nivelin e arsimit, orientimin seksual apo aftësitë e kufizuara. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Në përpjekje për të përmbushur misionin e vet, RrGGK ka përpiluar Planin Strategjik për vitet 2011 – 2013. Qëllimi i kësaj strategjie është që ta udhëzojë RrGGK-në në punën e vet gjatë kësaj periudhe. Kjo strategji u përpilua me kontributin e anëtarësisë së RrGGK-së, Bordit të Drejtorëve dhe partnerëve dhe palëve të interesit. Në të përcaktohen në detaje katër fushat programatike të strategjisë së RrGGK-së:

- I)** Zhvillimi i kapaciteteve të RrGGK-së;
- II)** Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
- III)** shëndeti i grave; dhe
- IV)** dhuna në familje dhe trafikimi.

Këto katër fusha programatike janë identifikuar nga anëtarët e RrGGK-së si katër fusha kritike të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje në vitet në vijim.

Në këtë raport për secilën nga këto fusha, është dhënë nga një pasqyrë e shkurtër e gjendjes aktuale; disa nga sfidat kryesore; qëllimi afatgjatë i RrGGK-së; të arriturat që RrGGK synon t'i arrijë brenda kësaj periudhe kohore; rezultatet e pritura nga këto të arritura; dhe aktivitetet që do të shpiejnë drejt arritjes së këtyre rezultateve.

Zhvillimi i Kapaciteteve të RrGGK-së

Gjendja

RrGGK u themelua në vitin 2000, fillimisht si rrjet joformal i grupeve dhe organizatave të grave nga vise të ndryshme të Kosovës. Që nga krijimi i tij, RrGGK është zhvilluar në një rrjet që avokon në emër të grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Si organizatë të përfaqësojë interesat e organizatave të grave që vijnë nga të gjitha grupet etnike në Kosovë dhe nga të gjitha viset e Kosovës, RrGGK është lider mes organizatave të shoqërisë civile në Kosovë dhe në rajon. RrGGK bashkëpunon në baza të rregullta me grupe të tjera të grave nga rajoni, në mënyrë formale dhe joformale, përmes grupeve si Lobi Rajonal i Grave për Drejtësi, Paqe dhe Siguri në Evropën Juglindore dhe Koalicionit të Grave në Paqe (në të kaluarën). Në vitin 2006, RrGGK u bë rrjeti i parë i organizatave jofitim-prurëse, joqeveritare që miratoi kodin e mirësjelljes, duke u bërë kështu shembull i transparencës dhe llogaridhënies.

Me gjithë këto të arritura, me tërheqjen e donatorëve nga Kosova, me rënien e përkrahjes së tyre, apo me ofrimin e përkrahjes për çështje tjera, organizatat e grave po përballen me sfida në sigurimin e fondeve për të vazhduar punën e tyre. Disa prej tyre nuk kanë shkathtësitë e duhura për ngritje të fondeve, për përpilim të projekteve në anglisht apo për t'iu qasur publikut dhe e kanë vështirë për tu përballë me këtë situatë të re dhe shumë konkurrese. Mbetet edhe shumë për tu bërë drejt implementimit të kodit të mirësjelljes së RrGGK-së.

Strategjia e RrGGK-së

Qëllimi i këtij programi kundrejt arritjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të RrGGK-së dhe anëtareve të saj, si dhe kundrejt implementimit të Kodit të Mirësjelljes, është: Grupet dhe organizatat e grave në Kosovë, në rajon dhe në botë bashkëpunojnë dhe komunikojnë rregullisht, dhe organizohen për të trajtuar brengat e përbashkëta. Të arriturat e pritura brenda viteve 2011-2013, si dhe rezultatet dhe veprimtaritë e pritura të cilat do t'i kontribuojnë këtyre rezultateve janë paraqitur në tabelën në vijim.

Objektivat	Rezultatet e pritura	Aktivitetet
<p>Sigurimi i një komunikimi dhe bashkëpunimi të rregullt dhe të vazhdueshëm në mes anëtareve të RrGGKsë dhe palëve me interes.</p>	<p>Anëtarët e RrGGKsë të informohen me iniciativat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGGKsë, mundësit e financimit, si dhe informata tjera të dobishme.</p>	<p>Organizimi i mbledhjeve dymujore të anëtarësisë.</p>
		<p>Shpërndarja e informative përmes postës elektronike.</p> <p>Organizimi i mbledhjeve vjetore të anëtarësisë.</p> <p>Përgatitja dhe shpërndarja e raportit vjetor të RrGGK-së.</p> <p>Koordinimi i aktiviteteve në mes anëtareve.</p> <p>Publikimi dhe shpërndarja e buletinit mujor (versioni elektronik).</p>
	<p>Puna e RrGGK-së dhe e anëtareve të saj të jetë më e promovuar tek partnerët potencial, tek aktivistet e grave në mbarë botën dhe tek përkrahësit potencial.</p>	<p>Informatat më të reja në ueb-faqe dhe Facebook.</p> <p>Publikimi i broshurës me profilet e anëtareve të RrGGKsë.</p> <p>Shpërndarja e broshurës tek grupet e interesit.</p> <p>Përgaditja e librit të RrGGK-së (2000-2010).</p> <p>Publikimi i broshurës & librit për 10 vjetorin e RrGGKsë, koktej me anëtarët, partnerët, donatorët, palët e interesit.</p>

Përmirësimi i kapaciteve institucionale të RrGGKsë dhe anëtareve të saj drejt një avokimi më të madh për kapacitete dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të rrjetit.

Mundësia për ngritje fondesh për më shumë anëtare, planifikimet efektive dhe iniciativat avokuese efektive.

Rritja e zbatimit të Kodit të Mirësjelljes nga anëtarët.

Ngritja e koordinimit të grupeve punuese të ekspertëve dhe avokuese brenda RrGGKsë (Politikat për Shëndetësi, Dhunë në familje & Trafikim) krijimi i strategjive për të ardhmen.

Vizita anëtareve për identifikimin e nevojave të tyre.

Të bëhet Plani i Shërbimeve për Anëtarët.

Implementimi i Planit të Shërbimeve për Anëtarët duke përfshirë: ngritjen e fondeve, përkthime, trajnime.

Përkrahja e anëtareve në avokim.

Përkrahja për funksionimin e OJQve të grave serbe në Kosovë.

Monitorimi vjetor i zbatimit të Kodit të Mirësjelljes.

Ofrimi i mentorimit individual dhe trajnimeve individuale dhe në grupe për zbatimin e mëtutjeshëm të Kodit.

Koordinimi i takimeve të rregullta.

Përkrahja në identifikimin e nevojave (analizave të problemeve dhe të palëve të interesit) të tyre.

Përkrahja në përpilimet e strategjisë së tyre.

Ngritja e fondeve për përkrahje të strategjisë së tyre.

	Përfshirja e më shumë aktivisteve të reja ne RrGGK.	T akime me grupe vajzash dhe organizata të rinjëve për shtytje të ideve dhe aktiviteteve të përbashkëta.
Rritja e bashkëpunimit në mes të grave në rajon lidhur me drejtësinë tranzicionale, paqen dhe sigurinë	Rritet bashkëpunimi mes organizatave të grave në rajon dhe identifikimi i çështjeve të përbashkëta.	Rrjetëzime dhe bashkëpunime me OJQ të grave në rajon; ndarja e përvojave, përkrahje njëra-tjetrës, ndërtimi i koalicioneve.
	Themelimi i gjykatës së grave të Ballkanit merr përkrahje dhe ka pjesëmarrje të grave kosovare.	D y takime regjionale lidhur me themelimin e gjykatës së grave të Ballkanit. K omunikime dhe takime të rregullta mes akterëve lidhur me themelimin.

Palët me interes, partnerët dhe përkrahësit

Për të arritur këto caqe strategjike, RRGK parashihet të vazhdojë bashkëpunimin me organizatat anëtare, Kvinna till Kvinna, Mot Foundation dhe UNIFEM. Organizatat anëtare të RrGGK-së, do të jenë përfitueset kryesore nga ky program. Grupet tjera të grave dhe qytetarët nga rajoni në përgjithësi do të jenë përfitues dytësor.

Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje

Gjendja

Militarizimi dhe konfliktet e armatosura në Evropën Juglindore gjatë viteve të 90-ta, përkrahur edhe nga reagimi ndërkombëtar i pasluftës, kanë kontribuar në margjinalizimin e grave në proceset vendimmarrëse. Deri në vitin 2008, ndërkombëtarët e Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe qeveria kosovare ishin përgjegjës për të qeverisur bashkërisht me Kosovën. Kjo ia bënte më të vështirë RrGGK-së kërkimin e llogarisë nga cilado palë sa i përket nevojave të grave. Për më tepër, përkundër ekzistimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Rezoluta 1325) mbi gratë, paqen dhe sigurinë, asnjë institucion qoftë ndërkombëtar qoftë kosovar nuk ka punuar për të siguruar pjesëmarrjen e grave në bisedimet për statusin politik të Kosovës. RrGGK bashkëpunoi me gra lidere dhe OJQ nga rajoni për të avokuar për përfshirje të grave në këtë proces. Për fat të keq, kjo nuk solli sukses.

Pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova më 17 shkurt 2008, rrethanat ndryshuan dhe RrGGK është duke gëzuar çdo herë e më shumë qasje në institucione përmes nismave të veta avokuese, gjë që më së miri dëshmohet me faktin që institucionet morën parasysh kërkesat e RrGGK-së sa i përket dhunës në familje dhe qasjes në ujë të pastër. Sidoqoftë, ende mbetet shumë punë për t'u bërë për të siguruar pjesëmarrje më të mirë të grave në procese politike dhe vendimmarrëse (që në fakt paraqet një nga prioritetet e RrGGK-së për vitet në vijim, siç parashtrohet më poshtë).

Gratë mbajnë 29% të ulëseve në Kuvendin e Kosovës (35 nga 120 ulëse).¹ Sipas ligjit të zgjedhjeve, qytetarët kanë një votë për parti politike dhe pesë për kandidatë nga lista e të njëjtës parti.² Politika në Kosovë mbetet ende në masë të gjerë e kontrolluar nga liderët e partive politike, e të gjitha partitë politike udhëhiqen nga burrat. Mungesa

1. Kuota që kërkon që se paku 30 për qind të të dy gjinive të jenë në listat e çdo partie politike ka kontribuar në këtë qëllim (Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-07, Art. 27). Në dispozicion në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L073_en.pdf.

2. Neni 110.4.

e demokracisë brenda partive dhe pjesëmarrja e pamjaftueshme e grave në to, bëjnë që ato të kenë ndikim minimal në vendimet e marra nga Kuvendi. Gratë gjithashtu mbeten në pozitë jo të favorshme sa i përket qasjes në resurse të partive politike. Propozimet më të reja për të hequr kuotën do të bënin edhe më të domosdoshme ngritjen e imazhit publik të grave për të siguruar se ato në të ardhmen do t'i fitojnë ulëset e duhura në Kuvend.

Nga 13 komisione parlamentare të Kuvendit të Kosovës, gratë udhëheqin vetëm me dy sish, edhe pse ato mbajnë 31 për qind të 144 vendeve në këto komisione. Komisioni për punë të jashtme, që numëron 11 anëtarë, nuk ka asnjë anëtare të gjinisë femërore, siç nuk ka as Komisioni për punë të brendshme dhe siguri. Një grua është emëruar si Kryesuese e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Megjithatë, asnjë nga nëntë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit nuk janë të gjinisë femërore, ndërsa në kabinetin e Presidentit, që ka shtatë anëtarë, vetëm dy janë gra.³ Buxheti i Kosovës kurrë nuk i është nënshtruar auditimit nga perspektiva gjinore, edhe pse mënyra e alokimit të resurseve është e një rëndësie kyçe.

Është krijuar grupi parlamentar i deputeteve, në të cilin marrin pjesë të gjitha deputetet e kuvendit. Ky grup në shkurt të vitit 2008 u riemërtua Grupi Joformal i Grave (GJG). Ai ka plan strategjik si dhe bord prej shtatë anëtarësh me përfaqësues nga të gjitha shtatë partitë politike. Përkrah takimeve të mbajtura, ato kanë filluar të monitorojnë Ligjin për Barazi Gjinore, por rezultatet e këtij monitorimi nuk janë bërë të qarta. Ato kanë avokuar së bashku në disa raste, si për çështjen e pushimit të lehonisë në Ligjin e punës dhe për emërimin e ambasadoreve nga Kuvendi. Megjithatë, GJG është përballë me disa sfida, më e madhja prej të cilave është politizimi. Në veçanti ishin gratë nga partia udhëheqëse, PDK, ato që janë munduar t'i kontrollojnë vendimet e marra nga Grupi.

Në qeverinë në largim, gratë kanë udhëhequr vetëm dy ministri (të administratës publike dhe energjisë dhe minierave). Dy gra tjera ishin të emëruara si zëvendësministre. Brenda ministrive, gratë zakonisht kanë mbajtur së paku

3. Këshilltari politik për çështje ligjore dhe Këshilltari politik për integrim evropian.

30 për qind të vendeve të punës, megjithëse kanë qenë mjaft të nënpërfaqësuar në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural (me vetëm 12%). Duke marrë parasysh numrin e madh të grave që angazhohen në sektorin e bujqësisë, e në veçanti pozitën e grave që udhëheqin me ekonomitë e tyre familjare, përkrahja e tyre është e domosdoshme. Agjencia për barazi gjinore, pikat kontaktuese për çështje gjinore dhe zyrtarët komunalë për çështje gjinore nuk kanë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore. Personat e emëruar në këto pozita, që më së shpeshti emërohen nga liderët politikë të tyre, në përgjithësi nuk kanë motivim për të shtyrë përpara çështjet gjinore qoftë nëpër komuna qoftë nëpër ministri. Për më tepër, vullneti politik për t'i përfshirë gratë në procese vendimmarrëse apo për të siguruar se zëri i grave do të dëgjohet ka qenë minimal.⁴

Decentralizimi ka nënkuptuar bartjen e përgjegjësive nga niveli shtetëror në nivel komunal. Në të ardhmen, decentralizimi do të nënkuptojë që komunat gradualisht të kenë çdo herë e më shumë shërbime ndaj qytetarëve në duart e tyre. Nevojitet ende punë për të zhvilluar kapacitetet e stafit të nivelit komunal. Decentralizimi mund të ketë ndikim mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara përmes Qendrave për Punë Sociale (QPS), të cilat janë përgjegjëse për të ofruar ndihmë për viktimat e dhunës në familje dhe për të siguruar kujdestari të fëmijëve. Arsimi dhe shëndetësia do të jenë kompetenca komunale. Duke marrë parasysh se zëri i grave zakonisht nuk është dëgjuar në vendimet e marra në nivel komunal, ngritja e zërit të tyre brenda komunës është e domosdoshme.

Kuota gjithashtu zbatohet në rastin e kuvendeve komunale. Vetëm dy kuvende komunale udhëhiqen nga femrat. Për momentin, gratë e porsa zgjedhura nëpër komuna gëzojnë përkrahje minimale dhe kanë përvojë minimale.

Në përgjithësi, partitë politike ende mbajnë shumë fuqi nëpër kuvendet komunale, kuvendin qendror dhe në qeveri. Pasi që numri i grave që mbajnë pozita udhëheqëse në parti është i ulët, niveli i pjesëmarrjes së barabartë të grave në vendimmarrje demokratike ka qenë minimal. Duhet bërë më shumë punë për të shtuar pjesëmarrjen e grave dhe

4. Shih Raportin e RrGGK-së, Monitorimi i zbatimit të Rezolutës së KS të OKB-së 1325 për Paqen dhe Sigurinë e Grave në Kosovë.

për të inkurajuar partitë politike që tu ofrojnë grave hapësirë për tu përfshirë në procese vendimmarrëse.

Mekanizmat institucional

Ekzistojnë shumë mekanizma institucionalë dhe juridikë që kontribuojnë në shtimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Neni 7.2 rregullon se “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”
- Ligji për barazi gjinore (2004) përkrah politikën e deklaruar në Kushtetutë dhe ndalon të gjitha format e drejtpërdrejta apo të tërthorta të diskriminimit gjinor. Në vitin 2005, Ligji përcaktoi se Zyra për barazi gjinore do të jetë institucion i veçantë qeveritar. Zyrtarët për barazi gjinore janë emëruar në komuna ndërsa nëpër ministri ekzistojnë Pikat kontaktuese për çështje gjinore.
- Ligji zgjedhor kërkon që 30 për qind e kuotës së kandidatëve për zgjedhje qendrore dhe komunale të jenë femra.
- Në kuptim të implementimit të Rezolutës 1325, KFOR-i dhe EULEX-i detyrohen t’i trajnojnë të gjithë të punësuarit sa i përket çështjeve gjinore, të sigurojnë pjesëmarrjen e grave në pozita vendimtarëve, dhe të sigurojnë se të drejtat e grave do të respektohen dhe mbrohen në çdo sferë të jetës. Plani i Veprimit për Promovimin e Barazisë Gjinore i OSBE-së (nga viti 2004) promovon parandalimin e diskriminimit gjinor në jetën politike, ushtarake, ekonomike, mjedisore dhe në fushën e të drejtave të njeriut. Zyra e UNMIK-ut për çështje gjinore (ZÇGJ) e themeluar në vitin 2000 ka për synim integrimin e çështjeve gjinore në shtyllat e UNMIK-ut dhe në zyrat tjera të ngjashme për të monitoruar dispozitat e barazisë gjinore.

Obligimet kryesore

Edhe pse gratë në Kosovë i kanë fituar disa të drejta dhe fuqi politike në këto 10 vitet e fundit, ende ekzistojnë tri pengesa kryesore që parandalojnë përparimin e mëtejshëm: normat kulturore mbi rolet shoqërore të femrave dhe meshkujve, niveli i ulët i arsimit, dhe mungesa e sigurisë ekonomike (përfshirë pronësinë mbi pronat).

Një nga pengesat e pjesëmarrjes së barabartë dhe efektive të grave në politikë dhe vendimmarrje është niveli i ulët i arsimit. Femrat kanë normë më të lartë të largimit nga shkollat pas shkollës nëntëvjeçare.⁵ Kjo normë rritet në rastin kur vajzat jetojnë në vise rurale dhe kur kemi të bëjmë me vajza nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian (RAE).

Arsyet e mundshme për normën e lartë të largimit nga shkollat janë: burimet e pamjaftueshme financiare, nevoja për punë, distancat më të largëta nga shkollat, dhe numri i pamjaftueshëm i shkollave.⁶ Si rrjedhojë e kësaj, femrat kanë normë tri herë më të lartë se sa meshkujt sa i përket gjasave për të qenë të papunësuar. Në vitin 2007, papunësia e grave ishte në normë prej 55.2% ndërsa tek meshkujt arrinte 28.5%.⁷ Nëse analizohen të dhënat e Indeksit të Zhvillimit Global të Bankës Botërore (WDI) shihet se në vitin 2008 vetëm 26.1% të tërë fuqisë punëtore të Kosovës mbulohet nga gratë.⁸ Gratë kryesisht punësohen në bujqësi, tregti me shumicë e pakicë, arsim, shëndetësi dhe punë sociale. Pa siguri ekonomike dhe pavarësi të financiare, fuqia vendimmarrëse është e limituar.

Më saktësisht, problemet tjera që i kontribuojnë pjesëmarrjes jo të barabartë të grave në vendimmarrje në Kosovë, përfshijnë:

5. Raporti i RRGK-së, Zbatimi i Rezolutës së KS të OKB-së 1325 në Kosovë (botimi i dytë.), Prishtinë: 2009, f. 54.

6. RRGK, Siguria fillon në shtëpi, f. 71.

7. Po aty f. 55.

8. Banka Botërore, Indeksi Botëror i Zhvillimit.

- Gratë janë pothuajse të papranishme në pozitën vendimmarrëse brenda partive politike, ndërsa partitë politike vazhdojnë të kenë kontroll të theksuar mbi të gjitha vendimet që merren në nivel komunal apo në nivel shteti. Shkak është mungesa e vullnetit tek liderët e partive politike për të ndarë autoritetin. Si rezultat i kësaj, gratë nuk kanë në dispozicion të tyre resurse financiare nga partia, e as përkrahje politike nga lidhshiptari partiak. Gratë rrallëherë sfidojnë liderët e fuqishëm të partive politike, në veçanti tek partitë politike kryesore (PDK, LDK, AAK). Njëkohësisht, aleancat e ngurta në nivel partish bëjnë që gratë të kenë vështirësi në avokimin për çështjet që kanë ndikim tek gratë.
- Gratë politikane rrallë takohen me votuesit e tyre dhe rrallë marrin vendimet nga ta. Shkaktar potencial kësaj është fakti që deputetet shpesh emërohen nga liderët politikë dhe nuk konsiderohen prioritet i tyre; në fakt, shumë besojnë se vetëm liderët e partive politike kanë të drejtë të takohen me votuesit. Deputeteve gjithashtu u mungojnë njohuritë e domosdoshme lidhur me mekanizmat që duhet shfrytëzuar për të mbledhur kontributin (ide, vërejtje etj.) e elektoratit. Si rezultat i kësaj, votuesit e të dyja gjinive fitojnë ndjenjë se politikanët nuk kujdesen për ta dhe nuk i përfaqësojnë interesat e tyre.⁹ Kjo kontribuon në shtimin e apatisë së qytetarëve dhe mund të ndikojë në gatishmërinë e qytetarëve për të votuar për kandidatet (apo kandidatët). Ekziston nevoja për të përmirësuar dhe shtuar lidhjen mes politikaneve dhe votuesve/elektoratit.
- Gratë në politikë rrallë kanë arritur t'i shtynë proceset që janë me interes për to në kuvende komunale apo në kuvend qendror, posaçërisht kur flitet për çështje që gratë mund t'i konsiderojnë si prioritet. Një faktor shkakor kyç është mungesa e demokracisë së brendshme në partitë politike që u përmend më lart. Si rezultat i gjendjes aktuale në partitë politike, gratë shpesh nuk e kanë guximin e duhur dhe nuk mund të ndikojnë në vendimet që merren brenda partive të tyre. Rezultat tjetër është se prioritetet e grave ka tendencë që të mos jenë pjesë e diskutimeve në procese vendimmarrëse.
- Kosova kurrë nuk ka kryer auditimin e buxhetit nga perspektiva gjinore. Pjesë e rëndësishme e

9. Bisedat e RRGK-së dhe anëtarëve të saj me gratë rurale.

pjesëmarrjes në procese vendimmarrëse është që të sigurohemi se fondet do të alokohen edhe për çështje që gratë i konsiderojnë si më të rëndësishme. Përse nuk është realizuar kurrë një auditim i tillë mbetet e paqartë, por rezultat i kësaj është se gratë nuk kanë dëshmi apo njohuri mbi atë se si shpenzohen tatimet që ato paguajnë apo mbi atë se si këto para po shpenzohen në çështje që kanë ndikim pozitiv në jetët e tyre.

- Deri tani, gratë kanë qenë në masë të madhe të përjashtuara nga bisedimet lidhur me statusin politik të Kosovës, me të ardhmen apo me çështje tjera që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë, Kosova nuk ka strategji për implementimin e Rezolutës 1325 mbi gratë, paqen dhe sigurinë, megjithëse implementimi i saj është kyç për Kosovën. Faktor shkakor, edhe në këtë rast, është kultura patriarkale që nuk i sheh gratë si vendimmarrëse e lëre më si lidere që bisedojnë mbi çështjet e sigurisë apo çështjet e rëndësishme kombëtare. Si pasojë, grave u është mohuar pjesëmarrja në tryezën e negociatave lidhur me statusin politik të Kosovës. Për këtë arsye, nevojat e veçanta që gratë kanë pas luftës, në veçanti gratë që kanë qenë viktimat të dhunimit, që kanë humbur të afërmit, dhe humbjet e theksuara financiare me të cilat janë përballë ato janë lënë tërësisht anash. Edhe çështja e personave të pagjetur, që gjithashtu lë shumë pasoja tek gratë, nuk u trajtua si duhet.

- Gratë nuk i mbulojnë 40% të pozitave të emëruara vendimmarrëse, siç parashihet me Ligjin për barazi gjinore. Më tej, gratë ende varen në masë të madhe nga kuota e ulëseve në Kuvend dhe në kuvende komunale. Siç edhe u përmend gjatë elaborimit mbi ligjin e ri zgjedhor, ka presion të shtuar nga disa parti politike dhe nga BE që të hiqet kjo kuota. Ekziston nevoja për të inkurajuar votimet për kandidatet e gjinisë femërore, si dhe për të emëruar më shumë gra në pozita vendimmarrëse. Shkaqet e këtij problemi janë normat sociale në të cilat gratë shihen si amvise dhe nëna dhe jo si lidere politike.¹⁰

10. Për shembull, gjatë një takimi të fundit me liderët politikë në një komunë, ata i kanë thënë RrGGK-së, "po, ne duhet të punojmë me nënat e ardhshme të fëmijëve tanë." RrGGK u desh t'i përmirësojë ata, duke theksuar se gratë luajnë role shtesë përveç asaj të nënës, dhe jo të gjitha gratë janë nëna.

Pasojat janë, mes tjerash, se gratë nuk mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procese vendimmarrëse dhe se Ligji për barazi gjinore nuk po zbatohet. Për shkak të ekzistimit të një qeverie të dominuar nga meshkujt, ka shumë pak gra në pozita vendimmarrëse në nivel komunal dhe në nivel qendror. Për këtë arsye, gjatë marrjes së vendimeve, shumë rrallë merren parasysh interesat e grave.

Strategjia e RRGK-së

Duke i pasur këto sfida, synimi afatgjatë është: Gratë të marrin pjesë aktive në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe shtetëror. Përfundimi i pritur në 2011-2013, rezultatet e pritura, si dhe aktivitetet që kontribuojnë në këto rezultate janë dhënë në hollësi në tabelën në vijim.

Objektivat	Rezultatet e pritura	Aktivitetet
Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në vendim-marrje në nivelin lokal dhe qendror.	Janë themeluar dhe funksionojnë grupet avokuese për Barazi Gjinore në 5 pilot komuna dhe në nivelin qendror.	<p>Takime me gratë politike dhe partitë politike në nivelin komunal.</p> <p>Takimet dymujore me grupet avokuese për barazi gjinore.</p> <p>Përkrahja për grupet avokuese për barazi gjinore që të avokojnë së paku një prioritet për gratë në nivel komunal.</p>

Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në vendim-marrje në nivelin lokal dhe qendror

Është ngritur komunikimi dhe bashkëpunimi në mes grave në politikë, OJQve të grave dhe grave votuese rreth çështjeve që i konsiderojnë me prioritet.

Takime ndërmjet grave në politikë, OJQve dhe grave votuese në nivel lokal dhe qendror.

Janë ndryshuar politikat publike që pasqyrojnë priritetet e grave votuese.

Hulumtimi mbi prioritetet e grave për të informuar propozimet e politikave publike në qeverisjen komunale/qendrore.

Takime mes grave në politikë dhe grave votuese për të diskutuar prioritetet dhe për të planifikuar strategji avokuese.

Avokim i përbashkët i grave në politikë, OJQve dhe grave votuese.

Janë pasqyruar prioritetet e avokuara nga gratë në buxhetin e Kosovës.

Auditimi i buxhetit të Kosovës nga perspektiva gjinore.

Avokimi i bazuar në auditimin e buxhetit nga perspektiva gjinore.

Është rritur pjesëmarrja e grave në proceset e vendimmarrjes lidhur me paqen dhe sigurinë, sipas Rezolutës 1325.

Avokimi për Planin Veprues Nacional (PVN) mbi Rezolutën 1325.

Monitorimi i PVN mbi Rezolutën 1325.

Avokimi për implementimin e Rezolutës 1325 nga institucionet ndërkombetare të Kosovës.

	<p>Më shumë gra të zgjedhura në nivelin lokal dhe qendror.</p>	<p>Takime në mes të grave votuese dhe grave kandidatë për zgjedhjet lokale.</p> <p>Mbulesë mediale nga mediat lokale për gratë kandidatë dhe politikanëve.</p> <p>Takime me liderët e partive politike për të avokuar për përfshirjen e më shumë femrave në pozitat vendimmarrëse.</p>
--	--	---

Përfituesit, Partnerët dhe Përkrahësit

Grupi i qëllimit dhe përfituesit parësorë do të jenë gratë politikanë në nivel komunal dhe shtetëror. Po ashtu, përfituese parësore do të jenë edhe gratë votuese në këto komuna, gjersa RrGGK do të mbështesë politikanët në takimet me gratë votuese dhe avokojë që të trajtohen prioritetet e grave votuese. Përfituesit dytësorë përfshijnë partitë politike të cilat synojnë reformim të partisë drejt demokracisë më të madhe në partitë e tyre, posaçërisht në nivel komunal; dhe burrat në politikë të cilët do të mësojnë më shumë për prioritetet e grave dhe si ato ndikojnë në shoqërinë si tërësi.

Organizatat anëtare të RrGGK-së do të vazhdojnë të jenë partnerë kyç drejt këtij synimi afatshkurtër. Kjo do të ulë dyfishimin e aktiviteteve dhe do të fuqizojë zërin e grave. Ngjashëm, RrGGK do të vazhdojë të komunikojë me organizatat tjera që kanë synime të ngjashme. Për arritjen e këtij synimi strategjik, bashkëpunimi i vazhdueshëm me gratë politikanë në nivelin shtetëror, saktësisht me grupin joformal të grave, dhe në nivelin komunal, do të jetë vendimtar. Po ashtu, RrGGK do të vazhdojë bashkëpunimin me përfituesit tjerë kyçë siç janë UNIFEM, National Democratic Institute, dhe National Endowment for Democracy. Mbështetja e mëtejme do të kërkohet nga UNDEF.K

E Drejta e Grave në Programin e Kujdesit Shëndetësor

Gjendja

Ndonëse gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së Kosovës, qasja në kujdes shëndetësor cilësor riprodhues dhe gjinekologjik është shumë e kufizuar. Sistemi publik shëndetësor, i financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, përbën vetëm 9.2% të shpenzimeve qeveritare.¹¹ Shpenzimi vjetor për kokë banori në shëndetësi është vetëm 35 Euro, më i ulëti në Evropë.¹² Gratë që jetojnë në viset rurale kanë theksuar se shpenzimet e udhëtimit janë pengesë për pranimin e trajtimit gjinekologjik dhe antenatal (gjatë shtatzënisë). Nuk ka buxhet për hulumtim dhe zhvillim.

Spektori i nënfinancuar shëndetësor ka ndikim të thellë negativ në shëndetin e gruas, që rezulton me një mungesë të përgjithshme të vetëdijes në lidhje me shëndetin gjinekologjik, kujdesin e paralindjes, si dhe parandalimin e kancerit në gji. Për shembull, 65% të grave të intervistuar nga UNICEF-i, theksuan se nuk besojnë se dietat ushqimore speciale janë të nevojshme gjatë shtatzënisë dhe 12.9% e të anketuarve kanë konfirmuar se pinë duhan gjatë shtatzënisë.¹³ Kjo mund të ketë pasoja të rënda si për gratë ashtu dhe për fëmijët, sikurse edhe raporton Raka në 2009:

Kosova ka një nga nivelet më të larta të vdekshmërisë perinatale (23 në 1,000 lindje të gjalla) dhe vdekjeve të nënave (7 në 100,000 lindje të gjalla) në Evropë. Është tejet shqetësues fakti se 40% të vdekshmërisë spitalore është tek foshnjat [...] Jetëgjatësia e pritur në lindje është më e ulëta në rajon, me 69 vite jetëgjatësi të pritur. Shumica e vdekjeve (53%) të popullatës vijnë nga sëmundjet jontjetëshe (sëmundjet kardiovaskulare, kanceri), pasuar nga vdekjet neonatale (28%) dhe vdekjet nga sëmundjet ngjitëse (12%).¹⁴

11. Lul Raka, Raport i historikut për hulumtimin në shëndetësi për Kosovën (nën 1244), Prishtinë: 2009, f. 10.

12. Po aty f. 10

13. UNICEF, Kujdesi antenatal në Kosovë: Cilësia dhe qasja, Prishtinë: 2009, f. 7.

14. Raka, f.11.

Prej 2000 dhe 2007, janë raportuar 24 vdekje nga objektet emergjente të kujdesit të obstetrisë.¹⁵ Vdekjet i janë atribuar hipertensionit të nxitur nga shtatzënësia, hemorragjisë, lindjes së bllokuar, komplikimeve të ndërlydhura me aborte, si dhe shkaqeve tjera indirekte.¹⁶ Këto raste dhe statistika vetëm sa e konfirmojnë nevojën urgjente për përmirësimin e shëndetit të grave në Kosovë.

Krahas sektorit të nënfinancuar të shëndetësisë, normat tradicionale socio-kulturore ndikojnë në shëndetin e grave në Kosovë. Ndonëse aborti (dhe disa herë përzgjedhja e gjinisë)¹⁷ është i pranueshëm nga gratë e martuara, seksi paramartesor dhe aborti tek femrat e pamartuara janë tema tabu. Një gjë e tillë ka rezultuar në aborte të pasigurta dhe braktisje të foshnjave nga nënat e reja. Ndonëse vlerat dhe mendimet që kanë të bëjnë me seksin paramartesor janë në proces të transformimit, posaçërisht në qytete të mëdha siç është Prishtina, vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet edukimit seksual dhe planifikimit të familjes.

Korniza institucionale

Ekzistojnë disa mekanizma institucionalë që ndihmojnë në përmirësimin dhe fuqizimin e sektorit shëndetësor të Kosovës në përgjithësi, duke e përmirësuar kështu shëndetin e grave:

- Komisioni për Shëndetësi, punë dhe mirënie sociale në Kuvendin e Kosovës është komisioni parlamentar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të legjislacionit shëndetësor dhe politikave të Qeverisë së Kosovës.
- Synimit Zhvillimor të Mijëvjeçarit në shëndetësi, të miratuara nga qeveria e Kosovës për 2005-2015 përfshijnë: 1) Fillimin e shëndetshëm në jetë; 2) Përmirësimin e shëndetit të rinjve; 3) Përmirësimi i

15. Tengiz Asatiani, Vlerësimi i kujdesit emergjent të obstetrisë në Kosovë, Prishtinë: 2008, f. 2

16. Po aty f. 2.

17. Diskutime në radhët e organizatave anëtare të RRGK-së që ndihmojnë gratë.

shëndetit mendor; 4) Zhvillimin e burimeve njerëzore për shëndetësi; 5) Uljen e sëmundjeve ngjitëse dhe jongjitëse; 6) Reformat institucionale; 7) Përmirësimin e menaxhimit në shëndetësi.

- Strategjia e shëndetit riprodhues dhe Ligji për shëndetin riprodhues

Sfidat kryesore

- Disa gra, veçanërisht ato në viset rurale, ngurrojnë të kryejnë ekzaminime obstetrike gjinekologjike sepse shumica e gjinekologëve janë meshkuj. Në kulturën e tyre, shumë gra dhe burra e konsiderojnë si gjë të turpshme që t'i lejohet një burri që nuk është burri i saj ta shoh një grua të zhveshur.
- Turpi lidhur me ekzaminimet gjinekologjike vlen edhe për pranimin e kujdesit antenatal.
- Për shkak se seksi paramartesor është tabu, prindërit nuk flasin me fëmijët e tyre, posaçërisht me vajzat, lidhur me seksin e sigurt. Nuk ka edukim seksual në shkolla, pikërisht për këtë arsye. Veç kësaj, disa herë rinia nuk e merr parasysh paralajmërimin e edukatorëve. Edukimi seksual peer-to-peer dhe diskutimet në grupe janë dëshmuar si më të suksesshmet.¹⁸
- Nuk ka vetëdije dhe edukim lidhur me kancerin e gjirit dhe atë të vezoreve.
- Sektori shëndetësor është skajshmërisht i nënfinancuar, që rezulton me mungesë të pajisjeve mjekësore, mungesë të specialistëve mjekësorë, cilësi të dobët të ofruesve të shërbimeve shëndetësore, si dhe infrastrukturë të dobët në objekte shëndetësore (si për shembull mungesë të ashensorëve apo ngrohjes).
- Qasje e kufizuar në asistencë për planifikim të familjes dhe kontraceptivë pa pagesë/me kosto të lirë.
- Shëndeti i grave dhe qasja në kujdes shëndetësor ndikohet edhe nga dhuna në familje.¹⁹

18. Sipas Caritas Luksemburg në Mal të Zi.

19. RrGGK, Hulumtim kërkimor për shtrirjen e dhunës në baza gjinore në Kosovë, dhe ndikimi i saj në shëndetin riprodhues të grave, Prishtinë: Kosovë, 2008.

Strategjia e RrGGK-së

Duke i pasur parasysh këto sfida, synimi afatgjatë është: Gratë kanë qasje dhe i qasen kujdesit shëndetësor cilësor me kosto të përballueshme. Organizatat kosovare të grave munden dhe e kanë ndihmuar këtë proces duke mundësuar diskutime lidhur me sfidat e shtjelluara në pjesën e mëparshme. RrGGK dhe anëtarët e saj janë të zotuar që të vazhdojnë të jenë të përfshira në mënyrë proaktive në hulumtimin e çështjeve që parandalojnë gratë në realizimin e të drejtës së tyre për qasje në kujdes shëndetësor; promovimin e vetëdijes publike lidhur me këto çështje; dhe avokimin për një reagim të përmirësuar institucional, saktësisht, rritjen e buxhetit. Përfundimi i pritura në 2011-2013, rezultatet e pritura, si dhe aktivitetet që kontribuojnë në këto rezultate janë shtjelluar në tabelën në vijim.

Objektivat	Rezultatet e pritura	Aktivitetet
Përmirësimi i qasjes në shërbimet kualitative shëndetësore për gratë.	Është bërë hulumtimi mbi gjendjen e shërbimeve në institucionet shëndetësore publike	Realizimi i hulumtimit në partneritet me organizatat që mirren me hulumtime.
	Më shumë gra dhe vajza janë të informuara mbi të drejtën e tyre për qasje në kujdesin shëndetësor dhe në zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe të mitrës.	Takime me gra mbi edukimin shëndetësor Fushatë mediale
	Rriten cilësitë e shërbimeve shëndetësore.	Të përkrahet grupi punues që avokon për rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe aktivitetet e tyre avokuese (p.sh. për buxhetin)

Përfituesit, partnerët dhe përkrahësit

Grupi i qëllimit dhe përfituesit parësorë do të jenë gratë kosovare, posaçërisht ato me qasje të kufizuar në shërbimet cilësore shëndetësore. Përfituesit dytësorë përfshijnë qytetarët në përgjithësi meqë e tërë shoqëria mund të përfitojë nga përmirësimet në sistemin shëndetësor të Kosovës.

Përsëri, organizatat anëtare të RrGGK-së do të jenë partnere kyçe në këto angazhime. Duke pasur parasysh mandatin e UNFPA-së si "agjenci udhëheqëse në shëndetin riprodhues në Kosovë," edhe ajo mund të mbështesë angazhimet e RrGGK-së. Përkrahës tjerë të mundshëm janë Organizata Botërore e Shëndetësisë, Aleanca Amerikane Ndërkombëtare Shëndetësore (AIHA), Institucionet publike të shëndetësisë në Kosovë, punonjësit shëndetësorë, si dhe qytetarët që mund të mbështesin përpjekjet e avokimit të RrGGK-së në këtë fushë.

Programi Kundër Dhunës në Familje dhe Trafikimit

Gjendja

Në anketimin mbarë-kosovar të RrGGK-së në 2008, rreth 43% të të anketuarve kanë përjetuar dhunë në familje në një moment të jetës së tyre.²⁰ Gratë kanë më shumë gjasa të vuajnë nga dhuna në familje: më shumë se 46% e të gjitha grave kanë përjetuar dhunë në familje krahasuar me 39.6% të të gjithë meshkujve. Dhuna në familje i është atribuar gjendjes së rëndë ekonomike, papunësisë së lartë, alkoolit, traumës nga lufta dhe mungesës së arsimit.

20. RrGGK, Siguria fillon në shtëpi, Prishtinë: 2008, f. 2.

Korniza institucionale

Ekziston një shumëllojshmëri e agjencive, organizatave dhe legjislacionit për promovimin e raportimit të dhunës në familje, parandalimin e dhunës në familje dhe ndihmës për viktimat e dhunës në familje:

- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) me Rekomandimin 19 për Dhunën ndaj grave përcakton parimet për përgjegjësinë e shteteve për të ndërmarrë masa adekuate për ta luftuar dhunën në familje.
- Deklarata e OKB-së e Parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit përcakton bazën e intervenimit dhe standardet për autoritetet në përgjigjen ndaj rasteve të dhunës në familje. Këto masa i ofrojnë viktimave si në vijim: përfaqësim gjyqësor; informata për procesin gjyqësor; rivendosje gjyqësore nga aktet e përjetuara; mbështetje psikologjike dhe mbështetje mjekësore; dhe strehim dhe asistencë.
- Kodi Penal i Kosovës (KPK) dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) përkufizojnë një varg veprash penale të kryera në marrëdhënien familjare që mund të konsiderohen si dhunë në familje.
- Policia e Kosovës ka njësi speciale kundër dhunës në familje. Njësitë Policore të Dhunës në Familje (NJDHF) parashohin që çdo stacion duhet t'i ketë dy zyrtarë të trajnuar për rastet e dhunës në familje (zakonisht një grua dhe një burrë) në kujdestari 24 orë në ditë.
- Ligji i kundër dhunës në familje dhe Plani shtetëror i veprimit kundër dhunës në familje janë miratuar në Kosovë.

Sfidat kryesore

Shumica e sfidave në parandalimin e dhunës në familje kanë të bëjnë me normat shoqërore dhe zbatimin e legjislacionit përkatës.

- Martesat kryesisht përfundojnë me shkurorëzim nëse raportohet dhuna në familje, posaçërisht nëse raportimi është kryer nga gruaja. Shpeshherë gratë nuk kanë resurse të mjaftueshme financiare për ta mbështetur veten pas shkurorëzimit.²¹
- Gjendja e dobët financiare e grave është arsye e rëndomtë që fëmijët lihen në kujdesin e burrit (kryerësit të veprës); gjendja ekonomike e kryerësit të veprës fiton përparësi gjatë shqyrtimit për mirëqenien fizike dhe psikologjike të fëmijës(ve). Dhënia e kujdestarisë së fëmijës te kryerësi i veprës mund ta vë fëmijën në rrezik të madh të dhunës dhe mosbindjes së grave për raportimin e dhunës në familje.
- Në sistemin gjyqësor, zvarritjet janë të rëndomta gjatë trajtimit dhe lëshimit të urdhrave për mbrojtje brenda afatit ligjor.
- Gjykatat dhe avokatët e preferojnë pajtimin, mirëpo kthimi i viktimës në vendbanimin e mëhershëm shpeshherë është dëshmuar të jetë joefektiv.
- Përceptimet patriarkale të thelluara në shoqëri rrezikojnë ndikimin në mendimet gjyqësore dhe rrjedhën e procedurës.
- Ekziston një mungesë e komunikimit ndërmjet gjykatave dhe policisë. Gjykatat rrallëherë ndërhyjnë kur urdhrat e mbrojtjes shkelen dhe/apo kur alimentacioni nuk paguhet. Ka vonesa të shpeshta, mungesë të urgjencës dhe përcjellje të pamjaftueshme.
- Disa prokurorë nuk kanë njohuri për sa i përket rregulloreve të dhunës në familje.
- Urdhërat për mbrojtje zakonisht konsiderohen si zëvendësim për iniciimin e procedurës penale.

Strategjia e RrGGK-së

Duke i pasur parasysh këto sfida, synimi afatgjatë është: Gratë jetojnë jetë pa trafikim dhe dhunë në familje. Përfundimi i prituri në 2011-2013, rezultatet e pritura dhe aktivitetet që kontribuojnë në këto rezultate janë shtjelluar në hollësi në tabelën në vijim.

21. Për më shumë informata për këto çështje, shih Raportin e RrGGK-së, Më shumë se "fjalë në letër"? Reagimi i aplikuesve të drejtësisë në dhunën në familje në Kosovë, Prishtinë, 2009.

Objektivat	Rezultatet e pritura	Aktivitetet
Përmirësimi i zbatimit të ligjeve dhe strategjive kundër trafikimit dhe dhunës në familje.	Është rritur implementimi i ligjit dhe strategjisë kundër trafikimit dhe dhunës në familje.	<p>Monitorimi i zbatimit</p> <p>Ngritja e vetëdijes lidhur me shkallën e zbatimit.</p> <p>Avokim për zbatimin e mëtejshëm</p>
Rritja e vetëdijësimit mbi legjislacionin dhe si të kërkohet ndihma.	Janë informuar më shumë qytetarë rreth legjislacionit përfshirë edhe meshkujt	<p>Fushatë vetëdijësuese</p>

Përfituesit, partnerët dhe përkrahësit

Përfitues parësorë do të jenë gratë dhe vajzat që janë në rrezik të dhunës në familje apo trafikimit. Cak do të jenë institucionet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit ekzistues kundër trafikimit dhe dhunës në familje, përfshirë: Policinë e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale, Agjencinë për Barazi Gjinore, Byrotë për ndihmë juridike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe EULEX-in. Veç kësaj, qytetarët në përgjithësi do të preken përmes ngritjes së vetëdijes publike lidhur me legjislacionin ekzistues dhe mënyrat për të kërkuar asistencë.

Një strehimore e trafikimit dhe gjashtë strehimore të dhunës në familje drejtohen nga anëtarët e RrGGK-së në Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Gjiilan. Veç kësaj, organizatat e grave, përfshirë anëtarët e RrGGK-së, organizojnë fushata të ngritjes së vetëdijes së publikut dhe nxisin raportimin e dhunës në familje. RrGGK do të vazhdojë t'i përfshijë në mënyrë aktive këta anëtarë në zbatimin e strategjisë. Gjithashtu, RrGGK do të vazhdojë bashkëpunimin e saj me institucionet e sipërpërmendura. Mbështetësit e këtyre angazhimeve mund të përfshijnë Nismën e UNDP-së Siguri të Grave dhe Fondin e Trustit të OKB-së për t'i Dhënë Fund Dhunës Ndaj Grave.

BORDI I RRGK GJATË VITIT 2010

Bordi i Drejtorëve të RrGGKsë u takua tri herë gjatë vitit 2010. Anëtarët e Bordit gjithashtu janë informuar rregullisht lidhur me aktivitetet e RrGGK-së përmes postës elektronike apo telefonit. Në fund të vitit 2010 përfundojnë mandatin pesë anëtarë të Bordit dhe anëtarët e rinj, të nominuar nga anëtarët e RrGGK-së, do të votohen gjatë Kuvendit Vjetor të Anëtareve. Bordi gjatë vitit 2010 përfshinte:

Belgjyza Muharremi – Kryetare e Bordit - (Dera e Hapur)
Arjeta Rexhaj (Qendra për Trajnime dhe Hulumtime Gjinore)
Ariana Qosja – Mustafa (Eksperte Ligjore)
Behar Selimi (Shërbimi Policor i Kosovës)
Nazlije Bala (Aktiviste për të drejtat e grave)
Shukrije Gashi (Partners kosova)
Veprora Shehu (Medica Kosova)

BORDI KËSHILLËDHËNËS I RRGK

Bordi këshillëdhënës i RrGGKsë ofron ekspertizë dhe këshilla për RrGGK bazuar në përvojën e tyre. Anëtarët janë:

Besim M. Kajtazi (Drejtor i Zyrës Ligjore - Qeveria e Kosovës)
Delina Fico (Administratë Publike, Shqipëri)
Marte Prenkpalaj (Shoqata Motrat Qiriazit)
Rachel Wareham – Këshilltare e Pavarur
Vjosa Dobruna (Aktiviste për të Drejtat e Njeriut)

)

STAFI I RRGGK GJATË VITIT 2010

Igballe Rogova
Drejtoreshë Ekzekutive

Besa Shehu
Menaxhere për Financa

Alba Loxha
Menaxhere për Informim dhe Qasje

Nicole Farnsworth
Këshilltare dhe Hulumtuese

Amy Chin
Praktikante

Aida Dërguti
(Gjysëm orari gjatë dhjetorit)

RAPORTI VJETOR I AUDITIT TË RRGK-SË

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR


Për: MENAXHIMENTIN EKZEKUTIV TË RRJETIT TË GRAVE TË KOSOVËS
(RRGK) PRISHTINË.

Ne kemi audituar kostot financiare dhe të dhënat plotësuese të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) të shprehura në EUR, për periudhën janar-dhjetor 2010. Këto pasqyra financiare dhe të dhënat plotësuese financiare janë përgjegjësi e menaxhimentit të projektve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një mendim mbi informatat e lartpërmendura financiare bazuar në auditimin tonë.

Ne kemi kryer auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA). Këto standarde kërkojnë që të planifikojmë dhe të zbatojmë auditimin për të marrë një siguri të arsyeshme se a i përmbajnë formularët për raportim deklaratat e gabuara. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të një prove, dëshmi që mbështet shumat dhe zbulimet në formularët për raportimin. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e duhur të kontabilitetit dhe raportimin e të dhënave në pasqyrat financiare. Ne besojmë se auditimi i ynë, ofron një bazë të arsyeshme.

Sipas mendimit tonë, të dhënat financiare, në mënyrë të drejtë i paraqesin të gjitha aspektet materiale, si dhe shprehim se Rrjetit të Grave të Kosovës që nga 31 Dhjetori 2010, dhe rezultatet e operacioneve, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet e Kontabilitetit të Kosovës.

Xhemail Syla
Statutory Auditor
"Syle I Iotla"#1
Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: +1377 44 156 921
Faks: +381 38 551 790


XHEMAIL SYLA
Auditor Ligjor
Statutory Auditor
044/156 921, Prishtinë


Prishtinë
24 04 2011

RAPORTI FINANCIAR I RRGK-SË PËR VITIN 2010

Donatorët	Projektet	Të bartura nga 2009	Të hyra 2010	Shpenzimet 2010	Të bartura në 2011
Kvinna till Kvinna	Forcimi i Kapaciteteve për Avokim të RrGGK	600	32,005.00	29,501.61	3,103.39
Mott Foundation	Mbështetje Institucionale për RrGGK	427.35		427.35	
UNIFEM Kosova	Ngritja e Vetëdijes për Mekanizmat e Barazise Gjinore në Kosovë	2,478.17	4,410.00	6,888.17	
BTD	Iniciativa Qytetare për Ngritjen e Qeverisjes së Mirë	17,791.40		17,791.40	
Urgent Action Fund	Përkrahje Aktiviteteve		3,110.59	3,110.59	
Mott Foundation 2010 - 2011	Mbështetje Institucionale për RrGGK		28,714.41	12,832.05	15,882.36
Global Fund for Women 2010 - 2011	Prodhim i Filmit Dokumentar		10,542.59	8,000.00	2,542.59
Ministria e Energjisë	Botimi i Librit		1,996.00	1,996.00	
Total		21,296.92	80,778.59	80,547.17	21,528.34

KOSTOT OPERATIVE DHE PROGRAMATIKE

Shpenzimet programore dhe operacionale të RrGGK 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2010



Shpenzimet e Programit	54.30%
Shpenzimet Operacionale	24.61%
Bartja në vitin 2011 (vazhdimi i projekteve)	21.52%

Lista e Gjërave që RrGGK ka Dhuruar Anëtareve të Saj

- | | |
|---------------------------|-----------------------------|
| 1 Laptop DELL | 1 Video kamerë FLIP |
| 1 Monitor DELL | 1 Inçizues zëri OLYMPUS |
| 1 Laptop TOSHIBA | 1 Printer HP 1018 |
| 1 Kompjuter DELL | 1 Mbajtëse dokumentesh |
| 4 Shtëpiza të kompjuterit | 1 Makinë fotokopjuese CANON |
| 1 UPS | 6 Muaj pagesë për internet |
| 2 Tavolina pune për zyre | 5 Karrike për zyre |

ANËTARET E RRGK-SË 2010

Alma

Shemsije Seferi
044 257 443
shemsijeseferi@hotmail.com
Sverkë, Pejë

Antigona

Rabe Rrustemi
044 192 232
r_rrustemi@hotmail.com
Skenderaj

Ato

Fikrije Ferizi
044 332 558
qendraeguas_ato@hotmail.com
Vushtri

Aureola

Sanije Grajçevci
044 502 578
aureola_p95@hotmail.com
Prishtinë

Bardha

Raza Sadrija
044 104 126
Prishtinë

Dera e Hapur

Belxhyzare Muharremi
044 124 423
c_opendoor@hotmail.com
Prishtinë

Diana

Silvana Vokshi
044 769 778
Gjakovë

Dora Dorës

Vjosa Curri
044 216 616
dora_dores@yahoo.com
Prishtinë

Dora e Ngrohtë

Drita Rama
044 264 102
drita.g.rama@gmail.com
Rahovec

Drita

Fexhrie Mavriqi
044 649 168
febimav@yahoo.com
Prishtinë

Duart e Dardanës (DeD)

Afërdita Koci
044 427 701
dardanafermere@yahoo.com
Gjakovë

Familja dhe Shpresa

Atifete Bytyqi
044 329 196
atifetebytyqi@hotmail.com
Klinë

Flaka

Shehindere Dedushi
044 195 940
delidedushi@hotmail.com
Lipjan

Foleja

Gjyzel Shaljani
044 219 612
gjyzelshaljani@gmail.com
Prizren

Gruaja Familjare

Nadire Kryeziu
044 217 223
gruaja_familjare@hotmail.com
Prizren

Handikos

Drita Vukshinaj
044 263 636
handikos_pz@hotmail.com
Prizren

Handikos

Mehreme Llumnica
044 198 688
mehremellumnica@hotmail.com
Prishtinë

Hanëmeli

Lirije Gash
044 343 709
liriyegas@hotmail.com
Prishtinë

Idemo Pravo

Zhivadinka Radosavlevic
064 447 0 967
Plemetin

Indira

Lize Marku
044 963 727
l_marku@hotmail.com
Videjë/Klinë

Institute of Psychology

Myrvete Bajrami
044 209 017
mbajrami@gmail.com
Prishtinë

Jeta

Safete Gacaferri
044 253 412
ojqjeta@yahoo.com
Deçan

Jeta Ime

Shqipe Bejtullahu
044 188 336
mylife_center@yahoo.com
Gjakovë

Jeto Jetën

Xhylnaze Bytyqi
044 187 021
jetojeten@hotmail.com
Prizren

Kalabria

Sevdie Bunjaku
044 234 190
kalabria24@hotmail.com
Prishtinë

Komitet Zena za Zastitu i Ljudska Prava

Snezana Karadzic
044 929 676
snezana.karadzic@gmail.com
Caglavica

Komiteti i Grave të Verbëra

Bajramshahe Jetullahu
044 185 298
kgvk_b@hotmail.com
Prishtinë

Kosovo Mental Disability Rights International

Zamira Hyseni
044 176 287
zhyseni@mdri.org
Prishtinë

Legjenda

Melihate Osmani
044 194 045
meliosmani@yahoo.com
Viti

Lepsa Buducnost

Radosava Mirkovic
064 533 7885
lepsa.buducnost@yahoo.com
Priluzje

Lidhja e Gjallë e Kosovës

Kadrije Berisha
044 227 820
kadrijeberisha@hotmail.com
Kaçanik

Lira

Valire Buza
044 189 775
valirebuza@hotmail.com
Prishtinë

Lulebora

Selvete Gashi
044 110 970
selvete.gashi@gmail.com
Prishtinë

Lulishtja

Sadije Dulahu
044 374 412
sadedulahu@hotmail.com
Dabishevc

Luna

Stanica Kovacevic
044 738 590
nvoluna@yahoo.com
Fushë Kosovë

Medica Kosova

Veprorre Shehu
044 188 316
medicam_kosova@yahoo.com
Gjakovë

Motrat Qiriaz

Marte Prenkpalaj
044 113 258
motratqiriazih@yahoo.com
Has / Prizren

Ne Jemi Pjesë e Botës

Gjylfidane Morina
044 197 851
njpb05@hotmail.com
Pejë

Norma

Valbona Salihu
044 126 428
shoqatanorma@yahoo.com
Prishtinë

Oda

Violeta Selimi
044 318 982
vselimi.oda@gmail.com
Prishtinë

OGPK

Rudina Gerdec - Llapashtica
044 308 758
aibi@hotmail.com
Prishtinë

One to One Kosova

Merita Halitaj
044 172 644
onetoonekosove@hotmail.com
Prizren / Pejë

Organizata edukative - kulturore

NISA

Igballe Berisha - Huduti
044 142 038
ikballekevser@hotmail.com
Prishtinë

Qendra e Gruas 'Liria'

Nazife Jonuzi
044 125 729
liriagjilan10@hotmail.com
Gjilan

Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita

Nafije Latifi
044 145 530
jeta.vita@yahoo.com
Prishtinë

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

Feride Rushtini
044 501 904
krct_org@yahoo.com
Prishtinë

Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Luljeta Vuniqi
044 116 898
qksgj_kgsc@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Gratë dhe Fëmijët Asebe

Esma Karanezi
044 128 126
Prizren

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve

Naime Sherifi
044 508 081
cpwcpishtina@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore

Hamijet Dedolli
hamijet_dedolli@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Mirëqenien e Gruas

Ardita Bala
044 223 543
pejawwc@yahoo.com
Pejë

Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve

Jubilea Kabashi
044 380 345
qsgf_pz@hotmail.com
Prizren

Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore

Diamant Binaku
044 174 429
qtsgj@yahoo.com
Prishtinë

Ruka + Ruci

Nevenka Rikallo
044 839 986
rikalonevenka@yahoo.com
Fushë Kosovë/Ugljare

Shoqata për Edukimin dhe Përkujdesjen e Familjes

Bahrije Deva
044 152 051
shepfgjakova@yahoo.com
Gjakovë

Shpresa

Sabrije Kukaj
044 170 652
sabrijekukaj@hotmail.com
Drenas

Shpresa & Shtëpitë e Fëmijëve

Valbona Çitaku
044 200 353
sdsf_ks@yahoo.com
Prishtinë

Shtëpia e Sigurtë

Sakibe Doli - Dobruna
044 161 857
linjajuaj@yahoo.com
Gjakovë

Teuta

Nexhmije Bytyqi
044 216 623
nexhmijeb@yahoo.com
Prizren

Venera

Miradije Gashi
044 223 418
ngo-venera@live.com
Pejë

Violete

Bedrije Shala
044 317 652
bedrije.shala@hotmail.com
Barilevë / Prishtinë

Vita - Jeta

Ajshe Nuhiu
044 277 421
ajshenuhiu@yahoo.com
Prishtinë

Zana

Tahire Gashi
044 406 812
shg_zana@hotmail.com
Klinë

Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës
Raporti Vjetor 2010

Përpiluar dhe dizajnuar nga
ALBA LOXHA

© 2010 Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Lejohet e drejta për ribotim.



Grupeve të Grave të Kosovës • Mreža Žena Kosova •
Women's Network of Kosovo • Mreža Žena Kosova •
Kosova Women's Network • Mreža Žena Kosova •
Brijeti i Grupeve të Grave të Kosovës •
Brijeti i Grupeve të Grave të Kosovës